



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.480/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit: Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESco) me numër të biznesit 71102130 me seli në Bulevardin “Bill Clinton” nr.5, kundër debitorit: “N.T.P “ S....” sh.p.k me të cilën e përfaqëson M.B. me adresë Lidhja-Lipjan, që ka të bëjë me pagesën e borxhit, si objekt i përmbartimit, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit të Përmbartuesi Privat Mubarak Shumolli P.nr.194/2019 të dt:11.03.2019, mbi caktimin e përmbartimit, me dt:25.08.2022, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET pjesërisht si i bazuar, prapësimi i debitorit: “N.T.P “ S....” sh.p.k me të cilën e përfaqëson M.B. me adresë-Lipjan, sa i përket borxhit në shumën 304.11euro si dhe kamatës në lartësisë 8% për borxhin kryesor, në këtë pjesë Urdhëri i Përmbartuesit Privat Mubarak Shumolli P.nr.194/2019 të dt:11.03.2019, anulohet.

II.REFUZOHET SI I PABAZUAR prapësimi i debitorit: “N.T.P “ S....” sh.p.k me të cilën e përfaqëson M.B. me adresë....-Lipjan, i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit numër P.nr.1271/2018 të dt:23.11.2018, në shumën 498.98 euro, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Mubarak Shumolli.

A r s y e t i m

Përmbartuesi privat Mubarak Shumolli me seli të zyrës në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm-Ekstraktin nga librat afariste DFE-.... të datës 09.03.2019 i cili paraqet dokument përmbartuese në bazë të nenit 21 , 22 dhe nenit 29 par.1.3 të LPP-së.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor, prapësim ka paraqitur debitori. Në prapësim ka theksuar se urdhri përmbarimor nuk është i saktë sepse debitori i përmbarimi ka kryer pagesë me datën 14.03.2019 në lartësinë prej 190.00 euro si dhe pagesën tjetër e ka bërë me datën 23.09.2016. Debitori me tej ka shtuar se këto dëshmi gjenden në shkresat e lëndës, po ashtu debitori ka deklarua se borxhi që ka mbetur pa u përmbushur është në lartësi prej 498.98 euro.

Nga këto arsye të cekura me larte debitori i përmbarimit i ka propozuar gjykatë që prapësimi të aprovohet si i bazuar dhe urdhri përmbarimor të anulohet.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit me të cilin kishte deklaruar se debitori i përmbarimit e pranon edhe vetë se ka obligim ndaj kreditorit, ndërsa sa i përket vlerës së borxhit të paraqitur në propozim për përmbarim, ku sipas kreditorit ka mundur të jetë gabim teknik, por kjo nuk është e rëndësishme ngase debitori e pranon borxhin përmes pohimit po ashtu edhe me pagesat e bërë gjatë kësaj periudhe.

Gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës dhe dokumentin e besueshëm- Ekstraktin nga librat afariste DFE-..., vlerësoj se urdhri përmbarimor duhet të lejohet në bazë të këtij dokumenti përmbarimor, por gjithashtu gjykata ka vlerësuar fletëpagesat e datës 14.03.2019 dhe të datës 23.03.2019 në bazë të të cilave konstatohet se borxhi i cili ka mbetur pa paguar është në lartësinë 498.98 euro dhe jo siç ishte në propozimin për përmbarim. Sa i përket kamatës gjykata edhe në këtë pjesë anuloi urdhrin e përmbarimit ngase në këtë dokument të besueshëm nuk është paraparë kamata në lartësinë prej 8%. Mbi këtë bazë gjykata e shkallës së parë aprovoj pjesërisht prapësimin, ngase vërejtja se dokumenti i besueshëm duhet të lejohet në bazë të shumës e cila ka arritur për pagesë, pa llogaritur kamatëvonesën.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë vendosi si në pikën I të dispozitivit, ngase gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe të njëjtin e aprovoj pjesërisht.

Gjykata ka vlerësuar dokumentin e besueshëm- Ekstraktin nga librat afariste DFE-.... të datës 09.03.2019 në bazë të cilës përmbaruesi privat ka zbatuar përmbarimin, i cili dokument përmbarues përbenë bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 21, 29 par.1.3 dhe neni 27, për të qenë të pambarueshme dhe njëkohësisht të përshtatshme për përmbarim. Njëherë gjykata vlerësoi se kartelën financiare, ngase nga kartela financiare vërehet se një pjesë e borxhit është paguar në data të caktuara nga ana e debitorit, por ka mbetur pa paguar një pjesë e detyrimit për të cilën është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimit.

Gjykata, bëri shikimin e shkresave të lëndës, analizoi pretendimet e debitorit në prapësim, dhe vlerësoi se janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, se nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e Urdhrit të Përmbaruesit Privat apo shtyrjen e zbatimit të përmbarimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par 1 pika 1 dhe nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë vendosi si në pikën II të dispozitivit, ngase gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe të njëjtin e refuzoj.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.480/22, dt.25.08.2022

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Dhomat e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.